

II. SISTEMI GJYQËSOR SHQIPTAR

Struktura e pushtetit gjyqësor në Shqipëri përcaktohet nga Kushtetuta ^[i], ku parashikohet se pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë.

Veç gjykatave të krijuara për gjykime të juridiksionit të përgjithshëm, Kushtetuta parashikon edhe krijimin e gjykatave të posaçme.

Në vijim jepet një përshkrim i secilës prej llojit të këtyre gjykatave dhe kompetencat e tyre lëndore dhe territoriale.

Në këtë seksion përshkruhet edhe Gjykata Kushtetuese, pavarësisht se kjo Gjykatë nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor, por funksionon si organi i fundit që zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.



2.1. GJYKATAT E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm^[ii] parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji “Për sistemin gjyqësor”. Gjykata të juridiksionit të përgjithshëm janë:

- Gjykatat e Shkallës së Parë
- Gjykatat e Apelit
- Gjykata e Lartë^[iii]


Nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm gjykohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me akuzat penale, paditë pronësore, dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jo pasuror (moral), zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën kontraktore, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e familjes, regjistrimi i subjekteve juridike jo tregtare (organizatat jofitimprurëse), vërtetimi i fakteve juridike, respektimi i të drejtave të tjera civile, të mbuluara nga Kodi Civil^[iv], etj.

Me qëllim gjykimin e çështjeve sipas specifikave, gjykata mund të organizohet në seksione të specializuara, kur kjo është e nevojshme dhe e mundshme, bazuar në kritere objektive, në veçanti në numrin e gjyqtarëve në gjykatë, llojin dhe numrin e çështjeve në të paktën tri vitet e fundit në atë gjykatë. Një gjykatë mund të ketë seksionin e çështjeve familjare, seksionin e çështjeve për të mitur, seksionin e çështjeve tregtare, etj.

Çdo çështje gjykohet eventualisht në tre nivelet e gjykatave. Dy nivelet e para, që përfshijnë gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, i zhvillojnë gjykimet dhe vendosin duke vlerësuar faktet e pretenduara, provat mbi të cilat mbështeten faktet dhe ligjin që pretendohet se është shkelur, ndërsa Gjykata e Lartë vlerëson vendimet e dy gjykatave të nivelit më të ulët, duke u kufizuar në ligjshmërinë e këtyre vendimeve, pa analizuar edhe një herë faktet dhe provat e paraqitura, për këtë arsye kjo gjykatë quhet ndryshe “gjykatë ligji”. E thënë më thjesht, Gjykata e Lartë bën “gjyqin e gjyqit”.

Gjykatat e Shkallës së Parë mund të kenë edhe degë. Degët e gjykatave janë të përhershme - duke ushtruar funksionin në mënyrë të përhershme jashtë selisë kryesore të gjykatave të shkallës së parë, si dhe të përkohshme - duke ushtruar funksionin në intervale kohore të rregullta jashtë selive kryesore të gjykatave të shkallës së parë. Degët e gjykatave gjykojnë vetëm çështje të cilat nuk janë urgjente, si dhe çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm përbëhen nga 22 gjykata të shkallës së parë, 6 gjykata apeli dhe Gjykata e Lartë. Më poshtë paraqitet shpërndarja e gjykatave të shkallës së parë sipas rrethëve gjyqësore, si dhe ndërlidhja e tyre me gjykatat përkatëse të apelit.



2.1.1 Gjykatat civile të shkallës së parë

Gjykatat e shkallës së parë janë niveli më i ulët i gjykatave të përgjithshme. Ato njihen me emrin “Gjykatë e Rrethit Gjyqësor”, shoqëruar me emrin e rrethit përkatës.

Gjykatat e shkallës së parë ushtrojnë kompetencat në një rreth gjyqësor, i cili është njësia ku funksionon një gjykatë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Një rreth gjyqësor mund të mbulojë një ose më shumë njësi të pushtetit vendor[v].

Rrethet gjyqësore dhe kompetencat tokësore (territori ku gjykata ka kompetencë) të gjykatave caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme:

- a) ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike;
- b) ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, eficientë e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Harta e ushtrimit të kompetencave, sipas territorit në rrethe gjyqësore mund të ndryshohet pas vlerësimit të bërë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, siç trajtohet në pjesët në vijim.

Paditë në çështjet civile si rregull ngrihen në gjykatën e rrethit ku banon i padituri, ose njëri prej tyre. Vetëm nëse ky i fundit nuk ka as vendbanim dhe as vendqëndrim në territorin e Shqipërisë, atëherë padia shqyrtohet nga gjykata e rrethit ku ka vendbanimin paditësi. Për paditë me palë të paditur personat juridikë, kompetente është gjykata ku personi juridik ka selinë. Person juridik është çdo subjekt i të drejtës i organizuar për qëllime tregtare si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionere, etj, ose

jo tregtare, si shoqata, qendra, fondacione, sindikata, parti politike, etj.

Paditë me objekt të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme ngrihen aty ku gjendet sendi i paluajtshëm, pavarësisht se ku banon i padituri.

Paditë që rrjedhin nga të drejtat trashëgimore, ngrihen në gjykatën ku ka pasur banimin e fundit trashëgimlënësi, e nëse nuk ky i fundit nuk ka pasur vendbanim, paditë ngrihen në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

Paditë që rrjedhin nga shkaktimi i një dëmi mund të ngrihen edhe aty ku është shkaktuar dëmi, p.sh. në rastin e një aksidenti automobilistik padia mund të ngrihet si aty ku ka banimin i padituri, ose ku ka qendrën kompania e sigurimit, ashtu edhe aty ku ka ndodhur aksidenti.

Pavarësisht rregullave të mësipërme, palët mund të bien dakord për të zgjedhur ndryshe nga rregullat e mësipërme lidhur me gjykatën që do shqyrtojë çështjen (kur gjykohen mosmarrëveshjet kontrakore dhe në kontratë palët kanë caktuar shprehimisht gjykatën kompetente), përveç rastit të padive për sendet e paluajtshme dhe paditë që rrjedhin nga të drejtat trashëgimore.

Gjykimet në këtë gjykatë zhvillohen me një gjyqtar ose me një trup prej tre gjyqtarësh në raste përjashtimore si vijon:

- a) paditë me objekt padie me vlere mbi 50 milionë lekë;
- b) paditë për shpalljen dhe zhdukjen e një personi;
- c) paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave;

Krahas kompetencave të renditura më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë[vi], si gjykata më e madhe në vend, ka dhe një funksion tjetër që është administrimi i Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse. Kjo gjykatë shqyrton kërkesat për krijimin, ndryshimin, mbylljen e organizatave jofitimprurëse.

2.1.2 Gjykatat penale të shkallës së parë

Gjykatat penale të shkallës së parë gjykojnë mbi akuzat e ngritura nga prokurori, si dhe kërkesa të tjera penale që i kërkojnë personat e interesuar, si për shembull: ankimi i të dëmtuarit nga vepra penale ndaj vendimit të pushimit të hetimit të bërë nga prokurori, kërkesat për përfitim nga amnistia, lirimi i parakohshëm nga burgimi, etj. Në të gjitha rastet, gjykata penale e juridiksionit të përgjithshëm nuk ka kompetencë të gjykojë çështje penale që janë në kompetencë të gjykatave të posaçme, si ajo për krimet e rënda.

Për shpërndarjen gjeografike të këtyre gjykatave vlejné të njëjtat rregulla si për gjykatat civile për të cilat folëm më sipër.

Gjykimi në këto gjykata bëhet nga një gjyqtar për çështjet e mëposhtme:

- a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;
- b) kërkesat për ekzekutimin e vendimeve;
- c) kërkesat për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja;
- d) veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet.

Të gjitha veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Vendimet e gjykatave të shkallës së parë nuk konsiderohen të formës së prerë nëse ndaj tyre ushtrohet e drejta e ankimit, përveç rasteve të veçanta si urdhrat e mbrojtjes, etj. Në rast se nuk paraqitet ankim, vendimet e gjykatave të shkallës së parë marrin formë të prerë dhe janë të ekzekutueshëm.

2.1.3 Gjykatat e apelit

Gjykatat e apelit shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore civile dhe gjykatat e rretheve gjyqësore penale, sipas ndarjes së treguar në grafikën e mësipërme. Gjykatat e apelit janë të organizuara dhe shpërndara në 6 qytete dhe konkretisht në Tiranë Shkodër, Durrës, Korçë, Gjirokastër dhe Vlorë^[vii].

Gjykatat e Apelit gjykojnë mbi argumentet e përfshira në ankimin e palëve dhe marrin në analizë cilësinë e vendimit dhe procedurës së ndjekur nga gjykata e rrethit gjyqësor. Gjykimi në këto gjykata është më i shkurtër dhe përgjithësisht nuk ka nevojë për më shumë se një seancë gjyqësore. Vendimet e gjykatave të apelit janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, përveç rasteve kur Gjykata e Lartë mund të urdhërojë pezullimin e tyre në rastin e paraqitjes së një ankimi pranë kësaj instance.

2.1.4 Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë është organi më i lartë gjyqësor në Shqipëri. Gjykata e Lartë gjykon si çështjet e gjykuara nga gjykatat e zakonshme dhe ato të gjykuara nga gjykatat e posaçme.

Gjykata e Lartë shqyrton rekursin në dhomë këshillimi me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në Kolegjet e Bashkuar (ku marrin pjesë të paktën dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë).

Kryetari i kolegjit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë të thjeshtë votash për periudhën njëvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Kolegjet sipas llojit të konfliktit, ndahen në:

- Kolegji Penal
- Kolegji Civil
- Kolegji Administrativ

Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë të gjykatave civile. Ai gjykon në trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Kolegji Penal shqyrton rekurse (ankime) ndaj vendimeve të formës së prerë të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Ai gjykon në trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, përveç çështjeve penale të gjykuara nga gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të cilat gjykohen nga një trup gjykues i përbërë nga pesë gjyqtarë. Në rastet e akuzave ndaj deputetëve, Kryeministrit, Presidentit të Republikës, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë vazhdon të gjykojë si gjykatë e shkallës së parë (juridiksion fillestar). Me reformën në drejtësi kjo kompetencë i kalon Gjykatës për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe gjykimi për zyrtarët e lartë të shtetit tashmë pritet të kalojë në tre shkallë gjykimi siç vepohet me shtetasit e zakonshëm.

Kolegji Administrativ shqyrton rekurse ndaj vendimeve të formës së prerë të gjykatave administrative. Trupat gjykues të Kolegjit Administrativ përbëhen nga tre gjyqtarë dhe për çështje që gjykojnë ligjshmërinë e akteve normative nënligjore trupat gjykues përbëhen nga pesë gjyqtarë.

Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara kryesohen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari. Kolegjet e Bashkuara gjykojnë kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Vendimi merret me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në gjykim. Në rast të një numri të barabartë votash, votimi bëhet sërish dhe nëse numri është sërish i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Vendimet e trupave gjykues të Gjykatës së Lartë, bashkë me mendimin e pakicës, publikohen në Buletinin Periodik të Gjykatës, në përputhje me ligjin *"Për Qendrën e Botimeve Zyrtare"*. Vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore publikohen në Fletoren Zyrtare të radhës^[viii].

Njësia e Shërbimit Ligjor

Pranë Gjykatës së Lartë funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë:

- a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim;
- b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës;
- c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari.

Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Kryetarit të Gjykatës, i cili për çdo çështje gjyqësore cakton këshilltarin ligjor, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.

Qendra e Dokumentacionit

Si pjesë e administratës pranë Gjykatës së Lartë është ngritur Qendra e Dokumentacionit e cila punon nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë dhe kryen këto detyra:

- a) siguron publikimin e menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) analizon dhe vlerëson vendimet e Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë;
- c) ndjek dhe studion praktikën gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmës-magjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.



2.2 GJYKATAT E POSAÇME

Gjykatat e posaçme janë gjykata që janë krijuar për gjykimin e çështjeve në fushat e mëposhtme:

- Për gjykimin e çështjeve administrative;
- Për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

2.2.1 Gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit

Gjykata administrative e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë mosmarrëveshjet lidhur me:


- a) kontratat administrative publike;
- b) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si lloje të tjerë të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- c) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

Gjykata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike.

Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, janë gjykatat administrative^[ix] të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit¹⁰ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Gjykatat administrative të shkallës së parë organizohen në numër dhe për territor të barabartë me atë të gjykatave të apelit civil, pra në 6 qytete dhe konkretisht në Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë.



Veprimtaria e gjykatës administrative të shkallës së parë, si rregull, ushtrohet në selinë e saj. Gjykata mund të zhvillojë një pjesë të veprimtarisë edhe jashtë selisë së saj, nëse kjo vlerësohet e nevojshme, lehtëson aksesin për cilëndo palë, kursen kohë ose shpenzime procedurale.

Gjykatat administrative janë kompetente për:

- a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
- b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;
- c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative^[xii];
- d) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë.
- e) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- f) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

Për sa i takon kompetencës se cila gjykatë do të gjykojë çështjen sipas shtrirjes së saj gjeografike, ndiqen rregullat e mëposhtme:

- a) Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë që përfshin territorin në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padia ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.
- b) Paditë për marrëdhëniet e punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij.
- c) Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij.
- d) Paditë për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, përveç sa është parashikuar në ligj, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin ku paditësi ka banimin ose vendqëndrimin.
- e) Kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur.

Gjykata Administrative e Apelit aktualisht është një e vetme dhe selia e saj është në Tiranë. Megjithatë, krijimi i gjykatave të tjera të këtij niveli mund të jetë objekt i dekreteve të ardhshme të Presidentit. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor, i cili këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim.

Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

- a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë me trup gjykues prej 3 gjyqtarësh;
- b) si shkallë e parë (juridiksion fillestar), mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh.

Procedura dhe mënyra e vendimmarrjes së gjykatave administrative është parimisht e njëjtë me atë të gjykatave civile.

2.2.2 Gjykatat për vepra penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar

Gjykata e posaçme e shkallës së parë dhe ajo e apelit, për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, organizohet dhe funksionon për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe selinë e ka në Tiranë.

Këto gjykata janë krijuar për herë të parë me ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor (2017), i hartuar në kuadër të reformës për drejtësi. Këto gjykata, janë ende duke u krijuar dhe praktika lidhur me gjykimet prej tyre do të jetë eksperiencë e të ardhmes.

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

a) Akuzat për veprat penale si më poshtë:

- Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
- Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë;
- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë;
- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike;
- Përfitimi i paligjshëm i interesave;
- Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike;
- Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit;
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare;
- Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj;
- Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë.



2.3 GJYKATA KUSHTETUESE

Gjykata Kushtetuese^[xii] është themeluar për të siguruar respektimin dhe zbatimin e Kushtetutës. Ajo është organi suprem i kontrollit kushtetues.

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Përbërja e saj përtërihet çdo 3 vjet, me një të tretën e saj. Anëtarët e rinj caktohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë. Ky rregull ndiqet edhe në rastet e përfundimit para afatit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vendos për:

- a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare;
- b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;

- c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- d) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- e) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre;
- f) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij; çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.
- g) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- h) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit^[xiii].

Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi e kanë:

- Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve.

Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe:

- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- organet e qeverisjes vendore, kur pretendojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre të parashikuara në Kushtetutë ose pozita e tyre kushtetuese;
- komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë kushtetuese të tyre ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
- organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre;
- gjykatat e të gjitha niveleve, kur gjatë gjykimin të një çështjeje konstatojnë se ligji ose akti normativ bie ndesh me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare;
- individët, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjet në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast të jo më pak se të dy të tretave të tyre.

Seancat janë si rregull me dyer të hapura. Nëse seanca do të zhvillohet me dyer të mbyllura, rregullat për këtë qëllim caktohen me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Gjatë zhvillimit të seancës respektohen rregullat e solemnitetit dhe të sigurisë, të cilat përcaktohen në Rregulloren e Gjykatës. Regjistrimet radiofonike, televizive, audio ose video nga përfaqësues të medias gjatë seancës plenare lejohen vetëm me pëlqimin e gjykatës, në varësi të çështjes konkrete.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese thërret dhe drejton seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese. Seanca,

si rregull, zhvillohet pa ndërprerje. Në raste të veçanta, kryesuesi i seancës, pas marrjes së mendimit të anëtarëve të trupit gjykues, mund të ndërpresë seancën kur është e nevojshme.

Njoftimi për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare, publike ose mbi bazë të dokumenteve (pa praninë e palëve dhe pa debat gjyqësor verbal), bëhet nga Drejtoria Gjyqësore, si rregull 30 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare, me përjashtim të rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ato hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.

^[i] <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>

^[ii] <http://www.gjykata.gov.al/>

^[iii] <http://www.gjykataelarte.gov.al>

^[iv] <http://www.qbz.gov.al/botime/kodi%20civil%202016.pdf>

^[v] Shih më shumë Dekretin 6201 të Presidentit të Republikës datë 8.6.2009 "PËR CAKTIMIN E KOMPETENCAVE TOKËSORE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË TË SECILËS PREJ TYRE"

^[vi] <http://www.gjykatatirana.gov.al/>

^[vii] Shih më shumë Dekretin Nr.6217, datë 7.7.2009 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së gjykatave të apelit".

^[viii] Shih më shumë: www.qbz.gov.al

^[ix] Shih më shumë ligjin Nr. 49/2012 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE"

^[x] <http://www.gjykataadministrativeapelit.al/>

^[xi] <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/135-ligj-nr-44-2015-kodi-i-procedurave-administrative-i-republikes-se-shqiperise>

^[xii] <http://www.gjk.gov.al/>

^[xiii] Shih më shumë nenin 134 të Kushtetutës"